



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:168503
Datë: 10.10.2024
Numri i dokumentit: 06278093

Ac.nr.3597/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi -Kryetar i Kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Lumni Sallauka anëtarë të kolegjit, në çështjen juridiko-civile të paditëses N. F. nga Gj., të cilen sipas autorizimit e përfaqëson F. S., avokat nga Gj. kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Gjilan, me objekt kontesti për pagesën e shpërblimeve jubilarë në vlerë 1114.98 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.2342/20 të datës 11.02.2022, sa i përket pikës II të dispozitivit lidhur me shpenzimet e procedurës, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **10.10.2024** nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Gjilan, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.2342/20, i datës 11.02.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar C.nr.2342/20 të datës 11.02.2022 në pikën e parë të dispozitivit ka konstatuar të tërhequr padinë e paditëses N. F. nga Gj., e paraqitur ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Gjilan, për pagesën e pagave jubilarë. Në pikën e dytë të dispozitivit ka theksuar se detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Gjilan që paditëses N. F. nga Gj. në emër të shpenzimeve të procedurës t’ia paguajë shumën prej 134 euro, afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit të përcaktuar ligjor, ankesë kanë ushtruar e paditura, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe atë lidhur me pikën e II-të të dispozitivit të aktvendimit me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë si të bazuar ankesën ta prish aktvendimin e ankimuar në pikën II të dispozitivit të aktvendimit

duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditëses në këtë pikë apo ta kthej çështjen në rigjykim dhe rivendoje.

Paditësja nuk ka parshtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të të njëjtave, e në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209, pika b), të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të paditurës është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton paditësja, N.F, përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 02.12.2020, ka ushtruar padi kundër të paditurës me objekt kontesti për pagesën e shpërblimeve jubilarë në vlerë 1114.98 euro.

Gjykata me datën 28.01.2022 ka pranuar parashtresën nga ana e përfaqësuesit të paditëses, ku në mes tjerash ka theksuar se e tërheqin pjesërisht padinë sa i përket kryerjes së borxhit pasi që e paditura e ka përmbushur në tërësi tani detyrimin ndaj paditëses, por kërkon që e paditura paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore edhe atë për përpilim të padisë shumë prej 104€, si dhe taksën gjyqësore në shumë prej 30€, përkatësisht shumë e përgjithshme prej 134 Euro.

Gjykata në lidhje me këtë çështje të paditurës nuk i dërgoi njoftimin, siç e parasheh neni 261.2 i LPK-së, pasi që ka pranuar parashtrese nga ana e të paditurës e cila e ka njoftuar gjykatën se lidhur me këto padi ajo si e paditur e ka përmbushur detyrimin e saj ndaj palëve paditëse, kurse nga gjendja e shpjeguar më lartë dhe duke u bazuar në nenin 261.3 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkelje Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, nuk i ka pranuar pretendimet ankimore të palës së paditur dhe e pranon përfundimin e gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm, pasi që gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur si në pikën II, të dispozitivit të aktvendimit të atakuar, me të cilin e ka detyruar të paditurën që paditëses t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës, duke u bazuar në nenin 452 të LPK-së, meqenëse pala e paditur i ka shkaktuar këto shpenzime procedurale, përkatësisht i ka dhënë shkas padisë së paditëses, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur ta obligojë të njëjtën për pagimin e këtyre shpenzimeve të cekura si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit të atakuar, prandaj aktvendimi në këtë pikë është vërtetuar, ndërsa pretendimet ankimore të palës së paditur u refuzuan të pathemelta. Paditësja padinë e ka parashtruar me datë 02.12.2020, ndërsa detyrimin e saj ndaj paditëses, e paditura e përmbushur me datë 28.01.2022, ndërsa menjëherë pas kësaj paditësja e ka tërheq padinë, sipas nenit 456, paragrafi 1 të LPK-së ku përcaktohet se *“Paditësi që e tërheqë padinë ka për detyrë që të paditurit t'ia shpërblej*

shpenzimet procedurale përveçse kur tërheqjen e padisë e ka bërë menjëherë pas përmbushjes së detyrimit nga ana e të paditurit”

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të paditësit, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për të marr një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3597/2022, data 10.10.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Ardian Ajvazi